



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3122/7 prot.

Datë 05.12.2025

V E N D I M
Nr.1802/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2025 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “APIS CONSTRUCTION shpk” & “2 T shpk”, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-63382-10-01-2025, me objekt “Rikonstruksioni i kanaleve të ujrave të larta”, me fond limit 63,776,178.00 (*gjashtëdhjetë e tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë*) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk”, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Ankimues:

OE “PE - VLA - KU” SHPK me NUIS K61716013M, me adresë: Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga Muzaket, Pallatet Vokshi, Hyrja 1, Kati . 7, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vlorë, me adresë: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”, Vlorë.

Subjekte të Interesuar:

BOE “APIS CONSTRUCTION shpk” me NUIS L41513008A, me adresë: Njesia Bashkiake Nr.4 Kodi Zip 1007, Rruga Aleksander Moisiu , Ndertesa 117, Zona kadastrale Nr.8130, Tiranë & “2 T shpk”.

BOE “C O L O M B O shpk” me NUIS J82916489E, me adresë: Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67, Fier & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk”.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I****Vlerësimi Paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

1.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-63382-10-01-2025, me objekt “Rikonstruksioni i kanaleve të ujrave të larta”, me fond limit 63,776,178.00 (*gjashtëdhjetë e tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë*) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 17.10.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 27.10.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. APIS CONSTRUCTION & 2 T shpk	55,144,173.22	I Kualifikuar
2. C O L O M B O shpk & ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk & ALBA KONSTRUKSION shpk	56,453,040.00	I kualifikuar
3. Boe IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P) shpk & VIANTE Konstruksion shpk & KUPA shpk	57,004,920.00	I Skualifikuar
4. PE - VLA - KU shpk	59,929,115.23	I kualifikuar

II.4 Në datën 31.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi Paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 66, datë 03.11.2025.

II.5. Në datën 03.11.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3122/2025 protokoli, me datë 03.11.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6034 e OE “PE - VLA - KU” Shpk, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë: BOE “APIS CONSTRUCTION shpk” & “2 T shpk” dhe BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3122/1 prot, datë

03.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi kriteret që OE “PE - VLA - KU” Shpk, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë: “BOE “APIS CONSTRUCTION shpk” & “2 T shpk” dhe BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit, të parashtruara në ankesën me nr. 3122 prot., datë 03.11.2025.

II.7. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, me shkresën nr. 18440/1 prot., datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3122/2 prot., datë 10.11.2025, ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PE - VLA - KU” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim është shprehur se ka vendosur **refuzimin e saj**.

II.8. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 18440/1 prot., datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3122/3 prot., datë 13.11.2025, ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PE - VLA - KU” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim është shprehur se ka vendosur **refuzimin e saj**.

II.9. Me shkresën me nr. 121 prot., datë 03.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3122/4 prot., datë 04.12.2025, operatori ekonomik ankimues “PE - VLA - KU” SHPK, ka dërguar argumenta shtesë.

II.10. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, argumente nga subjekte të interesuara, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PE - VLA - KU” Shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, : “....*Bashkimi i Operatoreve Ekonomike COLOMBO shpk & ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk & ALBA KONSTRUKSION shpk kane dhene oferten me vleren 56,453,040.00 (pesëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyzetë) Lekë pa TVSH. Operatorët pjesëmarrës ne kete marreveshje bashkepunimi, ne dijenine tone nuk kane kapacitetet e duhura per realizimin*

e objektit te prokurimit, pasi stafi Teknik i tyre nuk ka kualifikimet duhura per realizimin me sukses te objektit te prokurimit, gjithashtu dhe ndarjet e zerave te punimeve ne baze te perqindjes se gjithsecilit nuk jane ne perputhje me deklarimet e bera si per stafin Teknik ashtu edhe per mjetet e deklaruar.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pikat 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.3.7 autoriteti kontraktor ka përcaktuar: 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/Markshajder*
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi*
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik*
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik*
- 1 (një) Inxhinier Hidrogeolog*
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi*

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, diplomë universitare, librezë pune dhe CV*

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri. Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

- 3 (manovratorë) manovratorë të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)

- 2 (dy) shofer kamioni të pajisur me lejen e drejtimit përkatëse, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)*

- 1 (një) elektrikist të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- 2 (dy) hidraulik të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- 5 (pesë) hekurthyes të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- 5 (pesë) karpentier të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- 2 (dy) saldator të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- 1 (një) betonues të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues ≥ 18 ton	copë 3	Në pronësi ose me qira

Eskavator 0.25 m3	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator krahgjate	copë 1	Në pronësi ose me qira
Rul (cilinder) me dhembë	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vibrator thellesie,	copë 1	Në pronësi ose me qira
Pompe moto-5KF	copë 1	Në pronësi ose me qira
Betonjere 500 liter	copë 1	Në pronësi ose me qira
Buldozer S-80/100 KF	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vinç kulle 0.5 - 1 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Elektrosaldatrice	copë 1	Në pronësi ose me qira
Gazogjen 1 m3/ore	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autovinc deri ne 12 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vinc kulle 4-6 T me manovrator	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autovinc deri 2.5 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autobot uji	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autovinc deri ne 12 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Dumper 4 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Mikrosonde me drejtim me lazer	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator me paisje shtese per ngulje palankola	copë 1	Në pronësi ose me qira
Palankola metalike	50 ton	Në pronësi ose me qira
Fabrike betoni	copë 1	Në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi
Vinc eskavator	copë 1	Në pronësi ose me qira
Trapano elektrike	copë 4	Në pronësi ose me qira
Kokore	copë 60	Në pronësi ose me qira
Jeleke	copë 60	Në pronësi ose me qira
Tabela sinjalizuese rrugore	copë 10	Në pronësi ose me qira
Kuti ndihme e shpejtë	copë 2	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
 - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Liçencë transporti;
 - f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
 - g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:
 - a) Kontrata e qerasë
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

- e) Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);
- f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
- g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

III.1.2. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, në përmbushje të pikave të sipërcituara në DT, BOE "C O L O M B O shpk" & "ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk" & "ALBA KONSTRUKSION shpk, kanë bërë deklarimet, konkretisht si më poshtë vijon:

-Kontratë bashkëpunimi për tender (bashkim i përkohshëm i shoqërive), me datë 17.10.2025, shoqëruar me anëks kontartë për ndarjen e punimeve;

NENI 4

PERQINDJA E PJESEMARRJES NE BASHKEPUNIMIN E SHOQERIVE

4.1 Pjesemarrja e Kompanive ne kete bashkepunim shoqerish do te jete sipas perqindjes se meposhtme:

- ❖ Shoqeria “ALBA KONSTRUKSION” Sh.p.k do te mbuloje 51% te angazhimit tek kontrates kryesoreme Autoritetin Kontraktor.
- ❖ Shoqeria “ZEQILLARI” Sh.p.k do te mbuloje 36% te angazhimit te kontrates kryesoreme Autoritetin Kontraktor.
- ❖ Shoqeria “C O L O M B O” Sh.p.k do te mbuloje 13% te angazhimit te kontrates kryesoreme Autoritetin Kontraktor.

Ndarja e detajuar e puneve sipas zerave qe do te marr persiper cdo antar do te jete sipas preventivit te ndarjes se punimeve bashkangjitur kontrates se bashkepunimit .Te gjitha zerat e punimeve ne raport me perqindjen e percaktuar ne kontrate.

-Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit te OE “C O L O M B O shpk”;

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjës të nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve. Mesatarisht 77 punonjes per 3 muajt efundit Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. _____ me profesion Inxhinier Ndertimi Strukturiste punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Ing.Ndertimi Strukturiste. 2. _____ me profesion Inxhinier Hidroteknike punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinier Hidroteknike/Drejtues teknike ne licensen e shoqerise/Pergjegjes i Sigurise dhe Shendetit ne Pune/Ekspert Zjarrfikese/ Punonjes ne Lartesi. 3. _____ ne profesion Ing.Gjeodet/Topograf punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Ing.Gjeodet/Topograf. 4. _____ ne profesion Ing.Mjedisi punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Ing.Mjedisi. 5. _____ e profesion HidroGjeolog per shpime nentokesore punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Ing. HidroGjeolog per shpime nentokesore. 6. _____ me profesion Tek.Ndertimi punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Tek.Ndertimi. 7. _____ ne profesion Manovratore punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Manovratore. 8. _____ ne profesion Shofere punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Shofere. 9. _____ ne profesion Elektriciste punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Elektriciste. 10. _____ ne profesion Hidraulike punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Hidraulike. 11. _____ ne profesion Hekurthyes punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Hekurthyes.



12.

Shkëlzen Beqiri, Adam Gjokaj, et al. ne profesion **Karpentier** punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e **Karpentier**.

13.

Alfred Dhami dhe Dëshmorët me profesion **Saldatore** punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e **Saldatore**.

14.

et al. ne profesion **Betonues** punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e **Betonues**.

Makineri emjete

Po ☒ Jo ☐

Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshtë:

Nëpronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr.Lejes qarkullimit	Nr.Shasisë	Të tjera
Motopompe uji 5KF				
Betoniere 500 lit				
Vibrator betoni thellesie				
Vinc kulle 4-6 ton me manovrator				

12.

Profession: Adam Gios... ne profesion Karpentier

Elektrosaldatrice				
Buldozer				
Vinc kulle karrel 0.5-1 ton				
Gazogjen deri 1m3/ore				
Trapan elektike				
Kokore				
Jeleke				
Jelek pune				
Tabela sigurimi paralajmeruese rrugore				
Kuti ndihme shpejt				
Dumper kantieri 4 ton				



12. **Shërbimi: Prerim Adam Gjermani - H. Gjermani** ne profesion **Karpentier**



Meqira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr.Shasisë së mjetit	Nr.Kontsë qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
Autovinc deri 12 ton					
Eskavator me goma 0.25m3			17 10703		2
Autobot uji	A A 210 E 37				
Vinc eskavator					
Eskavator/ Sonde per ngulje palankolash	DEI 1110 111111				
Palankola					
Palankola			1		
Mikrosonde me lazer (Trencher) me vakum					
Kamion mbi 18 ton			VI	N	
Autovinc deri 2.5 ton					

Dumper kantieri 4 ton				
-----------------------	--	--	--	--

Kontratë furnizimi				
Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit(data e fillimit dhe mbarimit)	Tëtjera	
Linje prodhim betoni				
Linje prodhim betoni				

- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk”

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjës të nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve periudhen e tre muajve të fundit është mbi 10 punonjës. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: <u>Drejtuesit Teknikë</u> 1. Z. ... me profesion Inxhinier Gjeodet, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit Teknik

	2. ☐ me profesion Inxhinier Gjeoteknik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit Teknik 3. ☐ me profesion Inxhinier Mjedisi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit Teknik <u>Punonjes te kualifikuar</u> 4. ☐ trajnuar si "Pergjegjes per Sigurine e Shendetit ne Pune", i punësuar pranë shoqërisë sonë 5. ☐ me profesion Teknik Ndertimi i punësuar pranë shoqërisë sonë si Teknik Ndertimi 6. ☐ me profesion Manovrator, i kontraktuar nga shoqëria jone per kete procedure prokurimi 7. ☐ me profesion Shofer i punësuar pranë shoqërisë sonë si Shofer 8. ☐ me profesion Hekurkthyes, punësuar pranë shoqërisë sonë si Hekurkthyes 9. ☐ me profesion Hekurkthyes, punësuar pranë shoqërisë sonë si Hekurkthyes 10. ☐ me profesion Karpentier, punësuar pranë shoqërisë sonë si Karpentier 11. ☐ me profesion Karpentier, punësuar pranë shoqërisë sonë si Karpentier 12. ☐ me profesion Betonues punësuar pranë shoqërisë sonë si Betonues. Makineri e mjete Po [X] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	---

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë, si më poshtë:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Pompe uji				
Betoniere				
Trapan				
Kokore				
Jeleke				
Tabela kantieri				
Kuti e ndihmes se shpejte				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
Eskavator 0.25m3					
Vibrator thellesie					
Gazogjen					

Elektrosaldatrice					
Autovinc deri 12 ton					
Kamion mbi 18 ton					

Kontratë furnizimi				
Materiali/prod ukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1. Linje betoni				
2				
3				
4				

- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE “ALBA KONSTRUKSION shpk

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve 50 Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: <u>Staf drejtues teknik:</u>



ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 19001:2012;
OHSAS 18001:2007; ISO 27001:2013; ISO 50001;
ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO 13331 – 1:2002;
ISO-BS EN 15128:2005

CONSTRUCTION AND INFRASTRUCTURE

	me profesion inxhinier hidroteknike, drejtuese teknike, e punësuar pranë shoqërisë sonë me profesion inxhinier gjeodet, drejtues teknik, i punësuar pranë shoqërisë sonë; me profesion inxhinier gjeodet, drejtues teknik, i punësuar pranë shoqërisë sonë; me profesion inxhinier ndertimi, drejtues teknik, i punësuar pranë shoqërisë sonë Mjek i shoqërisë: <u>Specialist ekspert zjarrefikes:</u> i pajisur me çertifikimin përkatës në bazë të ligjit Nr.152/2015 me përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, e pajisur me çertifikimin përkatës në bazë të ligjit nr.10327 date 18/02/2010 dhe VKM nr.312 date 05.05.2010; <u>Teknike ndertimi 1:</u> <u>Punonjës hidraulik 1:</u> <u>Karpentier 2:</u> <u>Hekurthyes 2:</u>
--	--

CONSTRUCTION AND INFRASTRUCTURE

	<u>Punonjes saldator 1:</u>
	<u>Betonues 1:</u>
	<u>Eskavatorist/manovrator 4:</u>
	<u>Shofer per kamion 1, kategoria C:</u>
	Makineri e mjete Po [X] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

**C: DEKLARATË “PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME
PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera

CONSTRUCTION AND INFRASTRUCTURE

Kamion veteshkarkues me kapacitet min 20 ton	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure
Kamion veteshkarkues me kapacitet min 20 ton	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure
Eskavator krahe gjate	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure
Rul cilinder me dhembe	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure
Vibrator thellesie betoni	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure
Motopompe uji	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure
Betoniore 500 lt	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure
Vinc karrel 0.5 -1 ton	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure
Elektrosaldatrice	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure
Autovinc	AR 200/200		ISO 9001:2008 ; ISO 14001:2004 ; ISO 39001:2012; OHSAS 18001:2007;ISO 27001:2013;ISO50001; ISO 28001; ISO 1452 – 1:2009; ISO13331 – 1:2002; ISO-BS EN 15128:2005	Class Job to Construction Infrastructure

CONSTRUCTION AND INFRASTRUCTURE

Dumper 4 ton				
Trapano elektrike				
Kokore				
Jelek				
Tabela kantieri sinjalizuese				
Kuti e ndihmes se shpejte				

	Me qira	
--	---------	--

Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
Fabrike betoni				1	

III.1.3. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet;

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohe për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohe të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendas, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit European.”

III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose

palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.6. Komisioni konstaton, se BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, në përmbushje të kriterëve sa më sipër, kanë dorëzuar:

-Kontratë bashkëpunimi për tender me datë 17.10.2025 midis shoqërive “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, ku sipas NENI 4 PERQINDJA E PJESEMARRJES NE BASHKEPUNIMIN E SHOQERIVE 4.1 Pjesëmarrja e Kompanive ne kete bashkepunim shoqerish do te jete sipas perqindjes se meposhtme: “Shoqeria “ALBA KONSTRUKSION” Sh.p.k do te mbuloje 51% te angazhimit te kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor. “Shoqeria “COLOMBO” Sh.p.k do te mbuloje 13% te angazhimit te kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor. “Shoqeria “ZEQILLARI

CONSTRUCTION” Sh.p.k do te mbuloje 36% te angazhimit te kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor .Ndarja e detajuar e puneve sipas zerave qe do te marr persiper cdo antar do te jete sipas preventivit te ndarjes se punimeve bashkangjitur kontrates se bashkepunimit .Te gjitha zerat e punimeve ne raport me perqindjen e percaktuar ne kontrate. Prokurë e posacme me datë 17.10.2025, ku përcakton se përfaqësues i BOE shoqëria “COLOMBO” SHPK; Preventivi I ndarjes së punimeve për secilin anëtar të BOE;

-Formular të Vetdeklarimit, e operatorit ekonomik “ALBA KONSTRUKSION” SHPK;

-Formular të Vetdeklarimit, e operatorit ekonomik “ZEQILLARI CONSTRUCTION” SHPK;

-Formular të Vetdeklarimit, e operatorit ekonomik “COLOMBO” SHPK;

Referuar kontratë së bashkëpunimi e lidhur më datë 17.10.2025, midis operatorëve ekonomikë BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është *Bashkepunimi I shoqerive ka si qellim ofertimin dhe sirrjedhoje negocimin, lidhjen dhe realizimin procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë 17.10.2025 nga Autoriteti Kontraktitor Bashkia Vlorë me objekt “Rikonstruksioni i kanaleve të ujrave të larta” me fond limit 63,776,178.00 lekë pa TVSH. Shoqerite bien dakort te respektojne termat e ofertes bashkarisht ose vec e vec. Në nenin 4 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku NENI 4 PERQINDJA E PJESEMARRJES NE BASHKEPUNIMIN E SHOQERIVE 4.1 Pjesemarrja e Kompanive ne kete bashkepunim shoqerish do te jete sipas perqindjes se meposhtme: “Shoqeria “ALBA KONSTRUKSION” Sh.p.k do te mbuloje 51% te angazhimit te kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor. “Shoqeria “COLOMBO” Sh.p.k do te mbuloje 13% te angazhimit te kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor. “Shoqeria “ZEQILLARI CONSTRUCTION” Sh.p.k do te mbuloje 36% te angazhimit te kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor .Ndarja e detajuar e puneve sipas zerave qe do te marr persiper cdo antar do te jete sipas preventivit te ndarjes se punimeve bashkangjitur kontrates se bashkepunimit .Te gjitha zerat e punimeve ne raport me perqindjen e percaktuar ne kontrate. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së*

bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve në ofertën e paraqitur, ku janë përcaktuar zërat konkretë të punimeve, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi dhe sasia në %.

Në rastin konkret, referuar kontratës së bashkëpunimit, KPP konstaton se, anëtari i BOE, “ALBA KONSTRUKSION” Sh.p.k do të mbulojë 51% të angazhimit të kontratës kryesore me Autoritetin Kontraktor, duke marrë përsipër për të realizuar punimet sipas kapitujve: punime prishje, punime shtresash, punime gjurmimi, punime betoni, punime hekur betoni, për të cilat ka deklaruar në Formularin e Vetdeklarimit, se disponon stafin teknik sipas profileve të kërkuara në pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 të DT, dhe në raport me % e punimeve të marra përsipër dhe për zërat specifiktë punimeve për të cilat ka marrë përsipër ti realizojë, pra profilet si: inxhinierë gjeodetë, inxhinierë hidroteknik, inxhinierë ndërtimi, teknik i mesëm ndërtimi, punonjës hidraulik, punonjës karpentierë, punonjës hekurkthyes, punonjës saldatorë, punonjës betonues, punonjës eskavator/monavratorëm dhe punonjës shofer kamioni, të cilat shërbejnë për realizimin e punimeve të marra përsipër në raport edhe me natyrën dhe % e zërave të punimeve, sipas kontratës së bashkëpunimit. Anëtari i BOE, “Shoqeria “COLOMBO” Sh.p.k do të mbulojë 13% të angazhimit të kontratës kryesore me Autoritetin Kontraktor, duke marrë përsipër për të realizuar punimet sipas kapitujve: punime prishje, punime shtresash, punime gjurmimi, punime hekur betoni, punime analiza jashtë liste si Spostim i linjave të kanalizimeve që derdhen në kanal, Zhblllokim i linjave të kanalizimeve ekzistuese, Hapje mikrotuneli me mikrosonde me drejtim me lazer për kalimin e linjave elektrike dhe hidraulike, Transport me dumper brenda kantierit dhe Ngulje dhe shkulje palankola metalike, për të cilat ka deklaruar në Formularin e Vetdeklarimit, se disponon stafin teknik sipas profileve të kërkuara në pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 të DT, dhe në raport me % e punimeve të marra përsipër dhe për zërat specifiktë punimeve për të cilat ka marrë përsipër ti realizojë, pra profilet si: inxhinierë gjeodetë, inxhinierë hidroteknik, inxhinierë ndërtimi, inxhinierë hidrogjelogjik, inxhinierë mjedisi, teknik i mesëm ndërtimi, punonjës hidraulik, punonjës karpentierë, punonjës hekurkthyes, punonjës saldatorë, punonjës betonues, punonjës eskavator/monavrator, punonjës elektrikist dhe punonjës shofer kamioni, të cilat shërbejnë për realizimin e punimeve të marra përsipër në raport edhe me natyrën dhe % e zërave të punimeve, sipas kontratës së bashkëpunimit. Anëtari i BOE, “Shoqeria “ZEQILLARI CONSTRUCTION” Sh.p.k do të mbulojë 36% të angazhimit të kontratës kryesore me Autoritetin Kontraktor. Ndarja e detajuar e punëve sipas zërave që do të marrë përsipër çdo antar do të jetë sipas preventivit të ndarjes së punimeve bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit. Të gjitha zërat e punimeve në raport me përqindjen e përcaktuar në kontratë, duke marrë përsipër për të realizuar punimet sipas kapitujve: punime prishje, punime shtresash, punime betoni, punime hekur betoni, si dhe punime analizë jashtë liste zëri Zgare për kanal 8 (për kanal), për të cilat ka deklaruar në Formularin e Vetdeklarimit, se disponon stafin teknik sipas profileve të kërkuara në pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 të DT, dhe në raport me % e punimeve të marra përsipër dhe për zërat specifiktë punimeve për të cilat ka marrë përsipër ti realizojë, pra profilet si: inxhinierë gjeodetë, inxhinierë mjedisi, teknik i mesëm ndërtimi, punonjës karpentierë, punonjës hekurkthyes, punonjës betonues, punonjës monavrator dhe punonjës shofer, të cilat shërbejnë për realizimin e punimeve të marra përsipër në raport edhe me natyrën dhe % e zërave të punimeve, sipas kontratës së bashkëpunimit.

Referuar arsyes së pretendimit të OE ankimes, konkretisht lidhur me pretendimet e tij për, stafin teknik dhe disponimin e makinerive të deklaruar nga BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, materialeve të

fashikullit të shqyrtimit administrativ, KPP konstaton se, ky BOE ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), dokumentat si: marrëveshjen e bashkëpunimit, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për secilin antëtar të BOE, për të cilët në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Pra, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, secilin anëtar BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, duhet të deklarojë për punonjësit (stafin teknik) të kërkuar, referuar profilin të punës, numrit si dhe llojet e makinerive, numrit të tyre, të kërkuara në kriteret e DT (pikat 2.3.3+2.3.4+2.3.7). Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) nga BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit të secilit antëtar të BOE, konstatohet, se në lidhje me plotësimin e kërkesave për (stafin teknik) punonjësit sipas profileve të kërkuara në pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 të kriterëve të veçanata të kualifikimit, “BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, secili anëtar i BOE, kanë deklaruar në pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontratë”, se disponojnë këto punonjës specialistë (stafi teknik) sipas profile respektive, të cituar edhe në dokumentat e pikës III.1.2, ku kanë deklaruar drejtuesit teknik si edhe specialistët e certifikuar sipas profesioneve, ku për secilin prej tyre ka deklaruar emrin, profilin e punës, si dhe kualifikimin. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se kërkesat në fjalë janë pjesë e kapacitetit teknik, referuar kjo dokumenteve standarde të tenderit, dhe të deklaruara në seksionin përkatës të secilit Formular të antëtarëve të BOE, duke dhënë indicie dhe informacion mbi numrin dhe specialitetin e kërkuara sipas pikës 2.3.3 dhe 2.3.4. Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, **plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [...].**

Nisur nga pretendimet e ankimuesit, Komisioni gjykon se, punonjësit e deklaruar, kanë të evidentuar të dhënat si numrin e punonjësit si dhe profilin respektiv të kërkuar sipas pikave 2.3.3 dhe 2.3.4 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit, për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se, deklarimi i punonjësve të profilit sipas kërkesave të pikës 2.3.3 dhe 2.3.4 të DT në rubrikat përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për secilin nga anëtarët e BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të kapacitetit teknik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesat 2.3.3. dhe 2.3.4 e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret, referuar kontratës së bashkëpunimit, KPP konstaton se, anëtari i BOE, “ALBA KONSTRUKSION” Sh.p.k do të mbulojë 51% të angazhimit të kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor, duke marrë përsipër për të realizuar punimet sipas kapitujve: punime prishje, punime shtresash, punime gjurmimi, punime betoni, punime hekur betoni, për të cilat ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit, se disponon makineritë/mjeteve/pajisjet sipas llojit të kërkuar në pikën 2.3.7 të DT, dhe në raport me % e punimeve të marra përsipër dhe për zërat specifiktë punimeve për të cilat ka marrë përsipër ti realizojë, pra llojet e makineritë/mjeteve/pajisjet si: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues ≥ 18 ton, eskavator, rul, pompë, betoniera, elektrosaldatrice, autovinc, dumper, fabrikë betony me kontratë furnizimi, trapano elektrike, kokore, jeleke, tabela sinjalizuese rrugore, Kuti ndihme e shpejtë, të cilat shërbejnë për realizimin e punimeve të marra përsipër në raport edhe me natyrën dhe % e zërave të punimeve, sipas kontratës së bashkëpunimit. Anëtari i BOE, “Shoqeria “COLOMBO” Sh.p.k do të mbulojë 13% të angazhimit të kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor, duke marrë përsipër për të realizuar punimet sipas kapitujve: punime prishje, punime shtresash, punime gjurmimi, punime hekur betoni, punime analiza jashtë liste si Spostim i linjave të kanalizimeve që derdhen në kanal, Zhbllokimi i linjave të kanalizimeve ekzistuese, Hapje mikrotuneli me mikrosonde me drejtim me lazer për kalimin e linjave elektrike dhe hidraulike, Transport me dumper brenda kantierit dhe Ngulje dhe shkulje palankola metalike, për të cilat ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit, se disponon makineritë/mjeteve/pajisjet sipas llojit të kërkuar në pikën 2.3.7 të DT, dhe në raport me % e punimeve të marra përsipër dhe për zërat specifiktë punimeve për të cilat ka marrë përsipër ti

realizojë, pra llojet e makineritë/mjeteve/pajisjet si: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues ≥ 18 ton, Vibrator thellesie, Pompe moto-5KF, Betonjere, Buldozer, Vinç kulle, Elektrosaldatrice, Gazogjen, Autovinc, Autobot uji, Dumper, Mikrosonde me drejtim me lazer, Ekskavator me paisje shtese per ngulje palankola, Palankola metalike, Fabrike betoni me kontratë furnizimi, Vinc eskavator, Trapano elektrike, kokore, jeleke, tabela sinjalizuese rrugore, Kuti ndihme e shpejtë, të cilat shërbejnë për realizimin e punimeve të marra përsipër në raport edhe me natyrën dhe % e zërave të punimeve, sipas kontratës së bashkëpunimit. Anëtar i BOE, “Shoqeria “ZEQILLARI CONSTRUCTION” Sh.p.k do te mbuloje 36% te angazhimit te kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor .Ndarja e detajuar e puneve sipas zerave qe do te marr persiper cdo antar do te jete sipas preventivit te ndarjes se punimeve bashkangjitur kontrates se bashkepunimit .Te gjitha zerat e punimeve ne raport me perqindjen e percaktuar ne kontrate, duke marrë përsipër për të realizuar punimet sipas kapitujve: punime prishje, punime shtresash, punime betoni, punime hekur betoni, si dhe punime analizë jashtë liste zëri Zgare per kanalin Ø 8 (per kanalin), për të cilat ka deklaruar në Formularin e Vetdeklarimit, se disponon makineritë/mjeteve/pajisjet sipas llojit të kërkuar në pikën 2.3.7 të DT, dhe në raport me % e punimeve të marra përsipër dhe për zërat specifiktë punimeve për të cilat ka marrë përsipër ti realizojë, pra llojet e makineritë/mjeteve/pajisjet si: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues ≥ 18 ton, Vibrator thellesie, Betonjere, Elektrosaldatrice, Gazogjen, Autovinc, Fabrike betoni me kontratë furnizimi, Trapano elektrike, kokore, jeleke, tabela sinjalizuese rrugore, Kuti ndihme e shpejtë, të cilat shërbejnë për realizimin e punimeve të marra përsipër në raport edhe me natyrën dhe % e zërave të punimeve, sipas kontratës së bashkëpunimit. Ndërsa, në lidhje me disponimin e mjeteve, pika 2.3.7 e DT, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, secili anëtar BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, duhet të deklarojë se disponon mjete e kërkuara me qera/në pronësi/kontrata furnizimi stë kërkuar, referuar kriterit 2.3.7 në DT. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit të secilit antëra të BOE, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për disponimin e llojit të mjeteve në pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, operatorët ekonomikë “BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, kanë deklaruar në pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika C Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për rëalizimin e punimeve objekt kontrate”, se disponojnë secili anëtar i BOE, këto makineritë, sipas llojit të kërkuar, konkretisht të cituar edhe në dokumentat e pikës III.1.2, ku kanë deklaruar llojet e mjeteve me qera/në pronësi/kontrata furnizimi, ku për secilin prej tyre ka deklaruar llojin e mjetit, targa, nr. Lejes së qarkullimit, nr. Shasisë dhe sipas rastit kur janë me qera/pronësi/kontrate furnizimi. Nisur nga pretendimet e ankimesit, Komisioni gjykon se, disponimi i makierive/mjeteve/pajisjeve të deklaruar, kanë të evidentuar të dhënat si llojin e mjetit, targa, nr. Lejes së qarkullimit, nr. Shasisë dhe sipas rastit kur janë me qera/pronësi/kontrate furnizimi respektiv të kërkuar sipas pikës 2.3.7 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit, për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve

të kualifikimit, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se, deklarimi mbi disponimin e makinerive/pajisjeve/mjeteve sipas lloji të mjetit, targa, nr. Lejes së qarkullimit, nr. Shasisë dhe sipas rastit kur janë me qera/pronësi/kontrate furnizimi sipas kërkesave të pikës 2.3.7 të DT në rubrikën përkatëse të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për secilin nga anëtarët e BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se kërkesat në fjalë janë pjesë e kapacitetit teknik, referuar kjo dokumenteve standarde të tenderit, dhe të deklaruara në seksionin përkatës të secilit Formular të antërarëve të BOE, duke dhënë indicie dhe informacion mbi llojin e mjeteve të kërkuara sipas pikës 2.3.7.

Gjitashtu, në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “PE - VLA - KU” Shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, në lidhje me “....eksperiencat e kërkuara në DT dhe eksperiencave të paraqitura realisht nga operatorët brenda BOE...”, të cituar në shkresën me nr. 121 prot., datë 03.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3122/4 prot., datë 04.12.2025, ku ky i fundit ka dërguar argumenta shtesë, nuk do të merret në shqyrtim, për sa kohë ky pretendim nuk ka qënë pjesë e Formularit të Ankesës me nr. 3122/2025 protokolli, me datë 03.11.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6034.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PE - VLA - KU” Shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të BOE Fitues “APIS CONSTRUCTION shpk” & “2 T shpk”: *“Pavaresisht se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shpallur fituesin Operatorin pjesëmarrës i cili ka dhënë ofertën me të ulët, Operatori i PE-VLA-KU shpk, renditur në vendin e tretë, ngre pretendimet se vlerësimi i ofertës së dhënë për Bashkimi i Operatoreve “APIS KONSTRUKSION” shpk & “2 T” shpk, shpallur fitues, nuk është bërë në mënyrë të duhur dhe të sakte”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PE - VLA - KU” SHPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE Fitues “APIS CONSTRUCTION shpk” & “2 T shpk, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme për bashkimin e operatorëve ekonomike të renditur të dytët në kualifikim, nuk qëndrojnë, dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimesit në lidhje me kualifikimin e BOE Fitues “APIS CONSTRUCTION

shpk” & “2 T shpk, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukseesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar. Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

III.2.2. Parashikimi i nenit 110 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin

III.2.3. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.2.4. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë që përpara tij me vlerë më të ulët vijon të qëndrojë i kualifikuar një operator ekonomik edhe pas ankesës së bërë prej tij. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga sukseesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Pasi për sa kohë që pretendimet mbi s’kualifikimin e BOE “C O L O M B O shpk” & “ZEQILLARI CONSTRUCTION shpk” & “ALBA KONSTRUKSION shpk, të renditur të dytën në listën e kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi se këto pretendime nuk merren në shqyrtim dhe nuk qëndrojnë, duke në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe gjendja faktike juridike e kësaj BOE, do të vijojë të mbetet i kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për s’kualifikimin e ofertës së BOE Fitues “APIS CONSTRUCTION shpk” & “2 T shpk, nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, për këtë operator ekonomik pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës. Pasi, bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukseesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin,

ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PE - VLA - KU” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-63382-10-01-2025, me objekt “Rikonstruksioni i kanaleve të ujrave të larta”, me fond limit 63,776,178.00 (gjashtëdhjetë e tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PE - VLA - KU” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

